



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 qershori 2023
Nr. ref.: MK 2213/23

MENDIM KONKURRUES

i gjyqtarit

RADOMIR LABAN

në

rastin nr. KO139/21

Parashtrues

Fadil Nura dhe 9 deputetë tjerë

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-040, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 21 korrikut 2021, për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Duke shprehur që në fillim respektin tim ndaj mendimit të shumicës së gjyqtarëve se në këtë rast, Vendimi i kontestuar i Kuvendit nr. 08-V-036 nuk është në papajtueshmëri me nenin 65.9 [Kompetencat e Kuvendit].

Megjithatë, Unë si gjyqtar individual kam mendim konkurrues në lidhje me konkludimin e shumicës dhe nuk pajtohem me mendimin e shumicës. Unë pajtohem me mendimin e shumicës se Vendimi i Kuvendit nr. 08-V-036 nuk është në kundërshtim me nenin 65.9 [Kompetencia e Kuvendit], por gjithashtu konsideroj se Gjkata ka qenë e obliguar t'u përgjigjet të gjitha pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe t'i konstatoj të njëjtat në dispozitiv të aktgjykimit sepse vetëm dispozitivi i aktgjykimit i obligon të gjithë personat fizikë dhe juridikë t'i respektojnë ato.

Unë si gjyqtar pajtohem me gjendjen faktike siç është deklaruar dhe paraqitur në aktgjykim dhe e pranoj të njëjtën gjendje faktike si të saktë. Gjithashtu, Unë si gjyqtar, pajtohem me mënyrën se si janë parashtruar dhe paraqitur në aktgjykim pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe të njëjtat i pranoj si të sakta.

Megjithatë, nuk pajtohem me analizën ligjore në lidhje me pranueshmérinë e rastit dhe qëndrimin e shumicës në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndaria e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshém], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Për sa më sipër, dhe në pajtim me rregullat 62 dhe 63 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, për të ndjekur sa më lehtë dhe qartë arsyetimin e mendimit tim konkurruesh do **(I)** të bëjë vlerësimin e pranueshmérisë, në lidhje me pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtave nga Kapitulli II i Kushtetutës, përkatësisht nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës; **(II)** të bëjë vlerësimin e kushtetutshmérisë përsa i përket pretendimeve për shkeljen e të drejtave nga neni 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës; **(III)** të paraqesë vlerësimin e kushtetutshmérisë përsa i përket pretendimeve për shkeljen e të drejtave nga neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndaria e Pushtetit], neni 7 [Vlerat] të Kushtetutës; **(IV)** të paraqesë një përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndaria e Pushtetit], neni 7 [Vlerat], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshém], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

(I) Vlerësimi i pranueshmérisë në lidhje me pretendimet lidhur me shkeljen e të drejtave nga Kapitulli II i Kushtetutës, përkatësisht nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës

1. Fillimisht, duke vlerëuar kriteret e pranueshmérisë dhe duke vlerëuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës se përmes vendimit të kontestuar janë cenuar të drejtat kushtetuese të anëtarëve të shkarkuar të Bordit të ARH-së nga Kapitulli II i Kushtetutës, do të vlerësoj thelbin e pretendimeve të bëra për secilin nen përkatës të Kushtetutës.
2. Rikujtoj se, ndër të tjera, se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përmes vendimit të kontestuar janë cenuar të drejtat kushtetuese të anëtarëve të shkarkuar të Bordit të ARH-së nga Kapitulli II i Kushtetutës, për arsyet e mëposhtme:

Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshém] të Kushtetutës

3. Në thelb, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përmes vendimit të kontestuar janë cenuar të drejtat kushtetuese të anëtarëve të shkarkuar të Bordit të ARH-së, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshém] të Kushtetutës, sepse, sipas parashtruesve të kërkesës, Kuvendi nuk u ka dhënë mundësinë anëtarëve të shkarkuar të Bordit të ARH-së që të dëgjojen lidhur me arsyet e shkarkimit të tyre dhe vendimi i kontestuar nuk është arsyetuar mjaftueshëm.

Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës

4. Në ndërlidhje me këtë pretendim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se anëtarëve të shkarkuar të bordit të ARH-së u janë shkelur të drejtat, e garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, duke theksuar se „*rendi juridik i Kosovës nuk ofron një mjet efektiv juridik që anëtarët e shkarkuar të bordit të ARH t'i mbrojnë të drejtat e tyre*“.
5. Lidhur me pretendimet e sipërpërmendura të parashtruesve të kërkesës se vendimi i kontestuar shkel të drejtat dhe liritë themelore nga Kpitulli II i Kushtetutës, përkatësisht neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] si dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], Gjykata rikuajton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë vendimin [Nr. 08-V-040] e Kuvendit të 21 korrikut 2021, përmes të cilit u shkarkuan anëtarët e Bordit të ARH-së.
6. Rikuajtoj se përkitazi me kriteret e vlerësimit të kushtetutshmërisë së „ligjeve“ të miratuara nga Kuvendi dhe „vendimeve“ të miratuara nga Kuvendi, në kuptim të nenit 113.5, theksoj se kontestimi i kushtetutshmërisë së një ligji të miratuar nga Kuvendi. është dukshëm i ndryshëm nga konestimi i kushtetutshmërisë së një vendimi. Ky dallim konsiston pikërisht në faktin se çfarë përcakton përbajtjen e aktit, përkatësisht cilat janë pasojat juridike që prodhon akti i Kuvendit, përkatësisht nëse përbajtja e aktit të Kuvendit cenon interesin e përgjithshëm publik apo të drejtat kushtetuese individuale.
7. Prandaj, ajo që Gjykata është dashur të vlerësojë lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e të drejtave dhe lirive nga Kapitulli II i Kushtetutës, është çështja se çfarë pasojash juridike ka sjellë vendimi i kontestuar i Kuvendit për parashtruesit e kërkesës dhe nëse ata preken nga ky vendim, për të vlerësuar më tej nëse pretendimet e tillë hyjnë në fushën e zbatimit të nenit 113.5 të Kushtetutës.
8. Kuptimi i paraqitjes së shkeljeve në lidhje me aspektet materiale të aktit të Kuvendit duhet parë prej rastit në rast, duke vlerësuar pasojat e përbajtjes së tij, interesi i kujt cenohet me aktin e kontestuar. Përbajtja e një norme juridike mund të jetë në kundërshtim me normat kushtetuese, ashtu si përbajtja e një akti të Kuvendit mund të prekë interesat e përgjithshme publike ose të drejtat individuale.
9. Vërej se anëtarët e Bordit të ARH-së janë shkarkuar me vendimin e kontestuar të Kuvendit dhe në këto rrethana, Gjykata konstaton se të përmendurit e fundit preken drejtpërdrejt individualisht me vendimin e kontestuar.
10. Prandaj, nga sa më sipër, në rrethanat e rastit konkret, vlerësoj se anëtarët e shkarkuar të ARH-së janë prekur drejtpërdrejt nga vendimi i kontestuar.
11. Vërehet se pretendimet e parashtruesve të kërkesës se përmes aktit të kontestuar të Kuvendit janë shkelur të drejtat kushtetuese të anëtarëve të Bordit të ARH-së, të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, ngrenë çështje kushtetuese,

por në rr Ethanat e rastit konkret, jo nga paragrafi 5 i nenit 113 të Kushtetutës, sepse akti i kontestuar cilësohet si akt juridik që prek vetëm të drejtat individuale, në rastin konkret të drejtat individuale të anëtarëve të Bordit të ARH-së dhe jo interesat e përgjithshme publike.

12. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se anëtarëve të Bordit të ARH-së u janë shkelur të drejtat individuale, sepse „*rendi juridik i Kosovës nuk ofron një mjet efektiv juridik që anëtarët e shkarkuar të bordit të ARH t'i mbrojnë të drejtat e tyre*“. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se anëtarët e shkarkuar të Bordit të ARH-së nuk mund të iniciojnë procedurë në Gjykatën Themelore, duke pretenduar se, sipas ligjit aktual për kontestet administrative, vendimi i Kuvendit nuk është akt administrativ, por akt i një organi kushtetues që i nënshtronhet kontrollit kushtetues.
13. Me rastin e shqyrtimit të pretendimit të lartpërmendor, vlerësoj se nuk duhet të supozohet apriori se anëtarët e Bordit të ARH-së, si kategori e veçantë juridike, janë të përjashtuar nga detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike efektive kundër aktit të kontestuar të Kuvendit në procedurë të rregullt, sepse, siç u shpjegua më parë, i njëjti prek drejtpërdrejt të drejtat e tyre kushtetuese.
14. Vërehet se parashtruesit e kërkesës nuk argumentuan se ekziston një praktikë e gjykatave të rregullta e ngjashme me rr Ethanat e rastit konkret, në të cilën individët nuk kishin mundësi të kontestojnë vendimet e Kuvendit që prodhojnë pasoja juridike individuale.
15. Më tej dhe lidhur me këtë, vërej se në dispozitivin e vendimit të kontestuar nuk është vërtetuar shprehimisht se kundër atij vendimi është e ndaluar ankesa dhe as shfrytëzimi i ndonjë mjeti juridik dhe për më tepër, vendimi i kontestuar nuk përban udhëzim juridik për palët e prekura prej tij.
16. Përveç kësaj, shqyrtimi i shkresave të lëndës nuk rezultoi me informata nëse anëtarët e shkarkuar të Bordit të ARH-së kanë iniciuar procedurë pranë organeve kompetente për të kontestuar vendimin e Kuvendit me të cilin janë shkarkuar nga pozitat e tyre në Bordin e ARH-së..
17. Në këtë kuptim, bazuar në normat kushtetuese, në praktikën time, dhe duke iu referuar parimeve të vendosura nga GJEDNJ, rikujtoj se legjislacioni ynë nuk parasheh shprehimisht përjashtimin e kësaj kategorie individësh që ushtrojnë funksione publike, për të mos kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre në gjykatat e rregullta. Për me tepër, e drejta e tyre për qasje efektive në drejtësi buron nga Kushtetuta, edhe nëse një gjë të tillë shprehimisht nuk e përcakton ligji. (shih, në mënyrë analoge, GJEDNJ, rastin Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës, nr. 63235/oo, Aktgjykimi i 19 prillit 2007, paragrafi 62, dhe rastin e Gjykatës KI214/21, me parashtrues Avni Kastrati, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022, paragrafi 125).
18. Po ashtu rikujton se Ligji nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejshmë: LKA) ofron mjete juridike efektive për zgjidhjen e rastit të kësaj kategorie funksionarësh publik. Në këtë drejtim, Gjykata së pari thekson se vet qëllimi i LKA-së si ligj, siç përcaktohet në nenin 2 [Qëllimi] është të sigurojë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave dhe interesave të personave fizikë dhe juridikë

dhe palëve të tjera, të cilëve u janë shkelur të drejtat dhe interesat me: (i) aktet individuale; ose (ii) veprimet e organeve të administratës publike. Më tutje në nenin 3, paragrafi 1.1 i LKA-së përcaktohet se organet e administratës publike janë organe të administratës qendrore, ndërsa paragrafi 1.2 i të njëjtit nen cilëson si akt administrativ çdo vendim të organit administrativ të nxjerrë pas procedurës administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose tërthorazi cenon të drejtat, liritë apo interesat e personave fizikë dhe juridikë të njoitura ligjërisht. Përveç, dispozitës me të cilën përcaktohet qëllimi i ligjit, më konkretisht, nen 10 i LKA-së, ndër të tjera, parashikon mundësinë e fillimit të një konflikti administrativ kundër akteve për të cilat një person fizik ose juridik konsideron se është shkelur një e drejtë ose interes ligjor (shih, KI214/21, cituar me lart, paragrafi 115 dhe 116).

19. Në këtë kontekst i referohem edhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Vendimit nr. 29/09, të 21.10.2009, me parashtrues: *Grupi prej 30 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë*, nëpërmjet të cilit, ndër të tjera, kërkohej anulimi i Vendimit të Kuvendit [Nr. 190] të 16 qershorit 2008, për shkak të mosdhënies së pëlgimit për emërimin e z. Z.P, për anëtar të Gjykatës Supreme. Për përcaktimin e kompetencës së saj, gjykata vlerësoi nëse objekti i kontrollit kushtetues përpara saj është një akt me karakter normativ dhe nëse synimet e tij ngrenë çështje konflikti kompetencash ndërmjet autoriteteve qendrore apo lokale. Në dritën e rrethanave të çështjes, gjykata në fjalë konstatoi: „*Gjykata është shprehur më parë se në gjykimet e natyrës abstrakte nuk është kompetente të kontrollojë akte të karakterit individual. Duke qenë se vendimi i Kuvendit, i cili është objekt shqyrtimi, pasqyron vullnetin e Kuvendit për të mos dhënë pëlgimin për emërimin e një anëtarë të Gjykatës Supreme, Gjykata pranon se ky akt ka karakter individual. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se nuk është kompetente të kontrollojë vendimin e Kuvendit nr. 190, të 16.06.2008. Në përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa e ngritur nga një grup prej të paktën një të pestës së deputetëve (1/5) i referohet anulimit të vendimit të Kuvendit nr. 190, të 16.06.2008. duhet shfuqizuar për shkak të **mungesës së legjitimitetit të parashtruesve të kërkesës** dhe mungesës së juridiksionit të kësaj gjykate..*
20. Prandaj, bazuar në sa më sipër, konsideroj se pretendimi i parashtruesve të kërkesës se anëtarëve të Bordit të ARH-së nuk u jepen mjete efektive për të ushtruar të drejtat e tyre civile, nuk qëndron dhe nuk arsyetohet objektivisht, sepse asnjë dispozitë ligjore apo kushtetuese nuk ua ndalon anëtarëve të kësaj të fundit të drejtën për të kërkuar mbrojtjen ligjore të të drejtave të tyre në procedurë të rregullt, siç përcaktohet me nenin 54 të Kushtetutës.
21. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljet e të drejtave individuale të anëtarëve të Bordit të ARH-së, të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim të mëtejmë të meritave së kërkesës për arsyen se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar se legjislativi aktual e përjashton këtë kategori të zyrtarëve publikë nga detyrimi për të kërkuar mbrojtje ligjore pranë gjykatave të rregullta. Rrjedhimisht, kushti i shterimit të mjeteve juridike efektive në lidhje me këtë pjesë të kërkesës nuk është plotësuar.

22. Prandaj, bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e aktit të kontestuar, në lidhje me të drejtat e njeriut të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, si dhe anëtarët e Bordit të ARH-së nuk mund të lirohen nga detyrimi kushtetues për të shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të parashikuara me ligjet në fuqi në procedurë të rregullt, siç kërkohet me paragafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës.

(II) Vlerësimi i kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimet për shkeljen e të drejtave nga neni 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

23. Fillimisht, rikujtoj se lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës në thelb pretendojnë se:

a) bazuar në Ligjin për Hekurudha, ARH është organ i pavarur, dhe në këtë mënyrë hyn në grupin e institucioneve të parapara në Kapitullin XII të Kushtetutës dhe bie në fushëveprim të nenit 142 të Kushtetutës “*që rregullon agjencitë e pavarura*”; dhe se

b) përmes Vendimit të kontestuar, Kuvendi nuk ka respektuar pavarësinë e ARH-së, si agjenci apo institucion i pavarur dhe në mënyrë arbitrale, përmes shkarkimit të të gjithë anëtarëve të Bordit si organ kryesor i ARH-së, ka bllokuar punën dhe funksionimin e saj. Në këtë mënyrë parashtruesit pretendojnë se është shkelur pavarësia organizative dhe funksionale e ARH-së.

24. Së pari theksoj se Kushtetuta, në kapitullin XII të saj, ka listuar institucionet e pavarura, duke rregulluar rolin dhe statusin e tyre. Po ashtu, Kushtetuta në nenin 142 ka paraparë mundësinë që Kuvendi me ligj të themelojë agjenci të pavarura.

25. Në këtë kuptim, Gjykata u referohet institacioneve të pavarura sipas Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës, konkretisht neneve 132-135 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] 136-138 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]; 140 [Banka Qendrore e Kosovës]; dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave].

26. Përndryshe, vërej se po ashtu në Kapitullin XII, përkatësisht bazuar në nenin 142 të Kushtetutës ka autorizuar Kuvendin që me ligj përkatës të themeloj agjenci të pavarura, të cilat do të funksionojnë mbi bazën e një ligji të tillë. Së këndejmi, neni 142 i Kushtetutës përcakton se:

„Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institacione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.“

27. Rikujtoj se Kushtetuta, në kuptim të statusit bën dallimin në mes institucioneve të themeluara me Kushtetutë, përkatësisht atyre të përcaktuara në Kapitullin XII të Kushtetutës dhe agjencive të pavarura të themeluara mbi bazën nenit 142 të Kushtetutës. Në lidhje me të parat, roli dhe autorizimet kushtetuese janë shprehimisht të rregulluara me dispozita kushtetuese, ndërsa në lidhje me të dytë roli dhe autorizimet e tyre janë të përcaktuar me ligj (shih, rastin e Gjykatës, KO171/18, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 25 prillit 2019, paragrafi 157).
28. Në dritën e elaborimit si më sipër, rezulton që nenit 142 i Kushtetutës nuk e autorizon Kuvendin e Kosovës, që përmes ligjit të themelojë institucionë të tjera të pavarura kushtetuese me statusin e njëjtë si të institucioneve apo agjencive të pavarura të përcaktuara në Kapitullin XII të Kushtetutës. Për më tepër, rikujtoj ese sikurse parashtruesit i kërkesës ashtu edhe komisioni përkatës i Kuvendit nuk kanë ofruar sqarime përkatëse dhe konkrete nëse ARH bie apo jo në kuadër të fushëveprimit të nenit 142 të Kushtetutës. Për pasojë, në vlerësimin e këtij pretendimi specifik do të kufizohem në rolin mbiqyrës të Kuvendit, të përcaktuar me paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës, i cili përcakton që ai "mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit".
29. Përkitazi me pretendimin parashtruesve të kërkesës se Kuvendi nuk ka respektuar pavarësinë e ARH-së, si agjenci e pavarur dhe në mënyrë arbitrale, përmes shkarkimit të të gjithë anëtarëve të Bordit si organ kryesor i ARH-së, ka bllokuar punën dhe funksionimin e saj, rikujtoj se Komisioni i Kuvendit pas vlerësimit të Raportit të Punës së Bordit të ARH-së, kishte nxjerrë një rekomandim i cili përbante konstatimet për problemet e sistemit hekurudhor dhe çështjet e përgjegjësisë institucionale të ARH-së, me propozimin për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të ARH-së.
30. Më tej, vlerësoj se siç ka konstatuar më lart Kuvendi bazuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës ka ushtruar kompetencën e tij të mbikëqyrjes së institucioneve publike, të cilat në bazë të Kushtetutës apo ligjeve i raportojnë Kuvendit.
31. Në dritën e asaj që u tha më lart, Gjykata vlerëson se Kuvendi me rastin e shkarkimit të anëtarëve të Bordit të ARH-së ka vepruar në rolin e saj mbikëqyrës, sikurse është përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës dhe nenin 38 të Ligjit të Hekurudhave, dhe rrjedhimisht pretendimi i parashtruesve për shkelje të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës është i pabazuar në baza kushtetuese.

(III) Vlerësimi i kushtetutshmërisë, në lidhje me pretendimet për shkelje të të drejtave nga neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndaria e Pushtetit] dhe neni 7 [Vlerat] të Kushtetutës

32. Vërej se thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për aktin e kontestuar të Kuvendit i referohet mënyrës se si Kuvendi e ushtroi autoritetin e tij mbikëqyrës të përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës në lidhje me ARH-në, e cila rezultoi në miratimin e vendimit të kontestuar, përmes të cilin Kuvendi vendosi shkarkimin e anëtarëve të Bordit të ARH-së.

33. Lidhur me këto pretendime, rikujtoj pjesët përkatëse të parimeve të përgjithshme në lidhje me parimin e ndarjes së pushteteve të konstatuara përmes praktikës së Gjykatës, si në rastin KO219/19, në të cilin u theksua se parimi i sigurisë juridike dhe parashikueshmëria Mjanë karakteristika thelbësore të ligjit dhe pjesë përbërëse të parimit kushtetues të sundimit të ligjit. Siguria juridike është një nga shtyllat kryesore të sundimit të ligjit dhe kërkon, ndër të tjera, që rregullat të jenë të qarta dhe të sakta dhe të synojnë të sigurojnë që situatat dhe marrëdhëniet ligjore të mbeten të parashikueshme. Parashikueshmëria para së gjithash kërkon që norma juridike të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme, në mënyrë që t'u mundësohet individëve dhe personave juridikë të rregullojnë sjelljen e tyre në përpunje me të. Individët dhe personat e tjerë juridikë duhet të dinë saktësish se si dhe në çfarë mase preken nga një normë e caktuar juridike dhe si një normë e re juridike ndryshon statusin ose gjendjen e tyre të mëparshme të parashikuar nga një normë tjeter juridike. Organet publike gjatë hartimit të ligjeve duhet t'i kenë parasysh edhe këto parime themelore të sundimit të ligjit, si pjesë e rëndësishme e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës.
34. Gjykata më tej, sikurse ka theksuar ne praktikën e saj gjyqësore, rikujton se nenit 4 i Kushtetutës rregullon formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve, duke përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 4 se Kuvendi është organ përfaqësues i popullit dhe gjithashtu edhe organi më i lartë shtetëror që ushtron pushtetin legjislativ; Presidenti i Republikës së Kosovës sipas paragrafit 3 të nenit 4 të Kushtetutës përfaqëson unitetin e popullit dhe gjithashtu është përfaqësues i vendit brenda dhe jashtë, si dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve shtetërore; ndërsa, Qeveria e Republikës së Kosovës sipas paragrafit 4 të nenit 4 të Kushtetutës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe të politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar nga ana e Kuvendit. Së këndejmi, parimi i ndarjes së pushteteve përbën vlerë themelore demokratike dhe mbi bazën e të cilit është ndërtuar dhe funksionon rendi kushtetues i Republikës së Kosovës (Shih rastin KO43/19).
35. Duke patur për bazë elaborimin e mësipërm, si dhe duke ju referuar pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, vërej se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me rrethana që do të ngërthenin çështje që ndërlidhen me fushëveprimin e nenit 4 dhe 7 të Kushtetutës, dhe për këtë arsy, konsideroj se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës janë të pabazuara në baza kushtetuese.

(IV) Përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtrueve të kërkesës

36. Bazuar në sa më sipër, dhe duke marrë parasysh edhe shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në kërkesën e tyre:

- I. KONSIDEROJ SE Gjykata është dashur TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme për shqyrtim meritor të pretendimeve për shkeljen e të drejtave kushtetuese të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në lidhje me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës;
- II. KONSIDEROJ SE Gjykata është dashur TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme për shqyrtim meritor të pretendimeve për nenet: 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat] dhe 65.9 [Kompetencat e Kuvendit], si dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës;
- III. KONSIDEROJ SE Gjykata është dashur të KONSTATOJË se Vendimi i Kuvendit nr. 08-V-036 nuk është në papajtueshmëri me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 65.9 [Kompetencat e Kuvendit], si dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës;

Mendimi konkurrues është paraqitur nga gjyqtari;

Radomir Laban, gjyqtar



The image shows a handwritten signature "LABAN R" above a blue circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVES", "GJYKATA KUSHTETUOSE", "REPUBLICA", "KOSOVO", "CONSTITUTIONAL COURT", and "REPUBLIC OF KOSOVO".

Më 12 prill 2023 në Prishtinë